

VENDIM
Nr. 538, datë 18.6.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE TE MINISTRIA E FINANCIVE, PËR DEGËN E THESARIT PUKË, TË NJË AMBIENTI NË PRONËN ME NUMËR PASURIE NR. 1, NË ZONËN KADASTRALE NR. 3069, ME VENDNDODHJE NË QYTETIN E PUKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 513, DATË 15.8.2007, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCIVE, PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE”, DHE NR. 622, DATË 15.9.2006, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCIVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive te Ministria e Financave, për Degën e Thesarit Pukë, të një ambienti me sipërfaqe 156,6 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) m², me numër pasurie nr. 1, në zonën kadastrale nr. 3069, me vendndodhje në qytetin e Pukës, sipas vërtetimit hipotekor dhe hartës treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ambienti me sipërfaqe 156,6 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) m², në pronën me numër pasurie nr. 1, në zonën kadastrale nr. 3069, me vendndodhje në qytetin e Pukës, hiqet nga lista e inventarit të pronave të miratuar me vendimin nr. 513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të miratuar me vendimin nr. 622, datë 15.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave”.

3. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Kredive, Ministria e Financave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË

V È R T E T I M

NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. 8 date 14 / 01 / 2004, figuron e regjistruar në pronësi të :

INSTITUCIONI SHTETEROR PUBLIK	PJESA
AGJENSIA E TRAJTIMIT TE KREDIVE PUKË	
Përfaqësuar z.HALIT REXHEP DINI	

Pasuria me numër 1 e ndodhur në Zonën Kadastrale 3069 me
Sipërfaqe 156.6m², ne adresën QYTETI PUKË

Kufizimet e pasurisë janë:

V APARTAMENT BANIMI , L RRUGA AUTO
J NDERT KOM (A.KUÇI) , P FUSHA E SPORTIT

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme:

nr. hip. 1 , date 14 / 01 / 2004 , nr. hip. _____, date ____/____/_____
nr. hip. _____, date ____/____/_____, nr. hip. _____, date ____/____/_____
nr. hip. _____, date ____/____/_____, nr. hip. _____, date ____/____/_____
nr. hip. _____, date ____/____/_____, nr. hip. _____, date ____/____/_____

Barra mbi pasurinë : NUK KA

Komente nga Regjistruesi: _____

Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartën Treguese Provizore.

Zyra e Regjistrimit nuk garanton vërtetimin
Pronësisë përpara përfundimit të Regjistrimit
Fillestar sipas ligjit nr. 33/2012, date 24.04.2012

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas
kërkesës nr. 134 .
Date 07 /05 / 2015 paraqitur ne ZVRPP

Puke me, 07 / 05 / 2015

REGJISTRUESI


TONIN BALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PUKË
HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË										D. DATA		07/05/2015.	
ZONA KADASTRALE	3069	NR.PASURISË	1	VOL	8	FAQ	1	Ora		10.00			
INDEKSI I HARTES		SHKALLA		1:1000		Aplikimi nr.		134					
ADRESA E PASURISË: RRETHI		PUKË		B/K		Pukë		Q/F		Pukë			
RR/L		P/G		SH		K		AP					
B. KUFIZIMET		V.	Ap. Barimi	L.	Rruga Auto	J.	Nder Kom (A.KUÇI)	P.	Fusha e Sportit				
C. PRONARET		AGJENSIA E TRAJTIMIT TE KREDIVE PUKË											
		Përfaqesuar z.HALIT REXHEP DINI											
		0		0		0							
		0		0		0							
		Sipërfaqja 156.6m2											
												REGJISTRUESI TONIN BALA	



HARTOGRAFI : PETRIT DEDA

SPECIALISTI : ERMAL GJONI